



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI
VENDIM

Nr. 137, Datë 06.06.2022

MBI

**KËRKESËN E SHOQËRISË “ALBANIAN GREEN ENERGY” SH.P.K. PËR
RINOVIMIN E LICENCËS NR. 376, SERIA F17 NË VEPRIMTARINË E
FURNIZIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE, MIRATUAR ME VENDIMIN E
BORDIT TË ERE-S NR. 114, DATË 27.07.2012, I NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 16 dhe nenit 20, germa “b”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; nenit 67, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë” dhe nenit 15, të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 96, datë 17.06.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 06.06.2022, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 866/7 prot., datë 02.06.2022 të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, “Mbi kërkesën e shoqërisë “ALBANIAN GREEN ENERGY” sh.p.k., për rinovimin e licencës Nr. 376, Seria F17, në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 114, datë 27.07.2012, i ndryshuar”,

Konstatoi se:

- Në respektim të afateve procedurale është përpiluar Relacioni mbi refuzimin e kërkesës së shoqërisë “Albanian Green Energy” sh.p.k. për rinovimin e licencës Nr. 376, Seria F17 në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 114, datë 27.07.2012, i ndryshuar.
- Ndërkohë në ERE ka mbërritur shkresa nr. 577/1 prot., datë 01.06.2022, nëpërmjet së cilës shoqëria “Albanian Green Energy” sh.p.k. ka përcjellë dokumentacion plotësues.
- Ndodhur në kushtet kur edhe afatet procedurale për këtë praktikë janë drejt përfundimit, vlerësohet se nevojitet koha e mjaftueshme për të shqyrtuar këtë dokumentacion dhe për të paraqitur më pas relacionin me propozimin përfundimtar në lidhje me kërkesën e shoqërisë “Albanian Green Energy” sh.p.k.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Të shtyjë me 10 (dhjetë) ditë pune vendimarrjen përfundimtare të bordit të ERE-s në lidhje me kërkesën e shoqërisë “Albanian Green Energy” sh.p.k. për rinovimin e licencës nr. 376 Seria F17 në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 114, datë 27.07.2012, i ndryshuar.

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, të njoftojë aplikuesin për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit AHMETI